

Mbroni fëmijën tuaj nga gripi

Vaksina kundër gripit në Angli

Përfshin informacione për
prindërit dhe kujdestarët



Flu mmunisation

Ndihmon për të mbrojtur fëmijët, çdo dimër

5 arsye

pse ta vaksinoni fëmijën tuaj

1. Mbroni fëmijën tuaj

Vaksina do të ndihmojë në mbrojtjen e fëmijës tuaj kundër gripit dhe komplikimeve të rënda si bronkiti dhe pneumonia

2. Mbroni veten, familjen dhe miqtë tuaj

Vaksinimi i fëmijës suaj do të ndihmojë në mbrojtjen e miqve dhe familjarëve që janë më të pambrojtur

3. Nuk nevojitet injeksion

Spërkatësi për hundën është pa dhimbje dhe përdoret lehtë

4. Është më mirë se të sëmureni me grip

Spërkatësi për hundën ndihmon në mbrojtjen kundër gripit, u është dhënë miliona fëmijëve në mbarë botën dhe ka një rekord të shkëlqyer sigurie


5. Shmangni shpenzimet

Nëse fëmijën tuaj e zë gripi, mund t'ju duhet të merrni leje nga puna ose të organizoni kujdes alternativ për fëmijët




Vaksina e gripit ofrohet falas për:

Të gjithë fëmijët
2 ose 3 vjeç
(më 31 gusht
para se të fillojnë
vaksinimet kundër
gripit në vjeshtë)



Fëmijët e moshës
shkollore
(Nga fillimi deri
në vitin 11)

Fëmijët nga
mosha 6-muajshe
që kanë një
problem
shëndetësor,
të cilët janë më
të rrezikuar
nga gripi



Informacione të mëtejshme se cilët fëmijë
kualifikohen çdo vit mund të gjenden në:

www.nhs.uk/child-flu

Pse duhet ta bëj vaksinën kundër gripit?

Gripi mund të jetë një sëmundje shumë e keqe që shkakton temperaturë, lodhje ekstreme, dhimbje të muskujve dhe kyçeve, bllokim të hundëve, kollë të thatë dhe dhimbje fyti. Zakonisht, fëmijët fillojnë të ndihen më mirë brenda një jave.

Komplikacionet e gripit përfshijnë bronkitin akut, infeksionet e dhimbshme në vesh dhe pneumonia. Për disa fëmijë mund të jetë e nevojshme të shtrohen në spital për trajtim, duke përfshirë kujdesin intensiv.

Cilat janë dobitë e vaksinës?

Bërja e vaksinës do ta mbrojë fëmijën që të mos sëmuret tepër rëndë. Fëmijët nën moshën 5 vjeç kanë përqindjet më të larta të shtrimeve në spital për shkak të gripit.

Gjithashtu do të ulë rrezikun që persona të tjerë në familjen tuaj, të cilët mund të jenë më të rrezikuar nga gripi, si gjyshërit ose personat me sëmundje shëndetësore afatgjata, të marrin gripin nga fëmija juaj.

Mund të jetë mirë që të merrni pushim nga puna apo nga aktivitetet e tjera, në mënyrë që të kujdeseni për fëmijën tuaj nëse sëmureni vetë.



Sa e efektshme është vaksina?

Vaksina e gripit është mbrojtja më e mirë që kemi kundër këtij virusi të paparashikueshëm. Te fëmijët, mbrojtja nga vaksina ka qenë gjithnjë më e lartë sesa te të rriturit.

Ekzistojnë variante të ndryshme të virusit të gripit, dhe variantet që ka më tepër gjasa të shkaktojnë gripin identifikohen që para se të fillojë sezoni i gripit. Më pas krijohen vaksina që përputhen sa më shumë me to – zakonisht ato ofrojnë mbrojtje deri në njëfarë mase edhe nëse nuk është gjetja perfekte.

Viruset e gripit mund të ndryshojnë çdo vit, ndaj vaksina përditësohet çdo vit. Dhe mbrojtja nga vaksina mund të zbehet me kalimin e kohës. Prandaj rekomandojmë që fëmija juaj të vaksinohet kundër gripit këtë vit, edhe nëse është vaksinuar vitin e kaluar.

Kush do t'ia bëjë vaksinën fëmijës tim?

Fëmijët e moshës 2 dhe 3 vjeç do të vaksinohen në klinikën e tyre të përgjithshme, zakonisht nga infermierja e klinikës.

Fëmijëve të moshës shkollore do t'u ofrohet vaksina në shkollë, dhe do të ofrohen mundësi të mëtejshme për t'u vaksinuar, mundësisht në klinikat e komunitetit, për këdo që nuk arrin ta bëjë në shkollë.

Fëmijëve që shkollohen në shtëpi do t'u ofrohet vaksina nëse janë në një grupmoshë që kualifikohet. Prindërit mund të marrin informacion lidhur me organizimet te Departamenti i Autoritetit Lokal të Arsimit.

Si do të jepet vaksina?

Për shumicën e fëmijëve, vaksina bëhet në formën e një spërkatjeje në hundë. Nëse spërkatja në hundë nuk është e përshtatshme për një fëmijë, mund të bëhet një injektim, zakonisht në muskulin e pjesës së sipërme të krahut.

Si funksionon spërkatja për hundën?

Spërkatja për hundën përmban viruse që janë dobësuar për të mos lejuar shkaktimin e gripit, por do ta ndihmojnë fëmijën tuaj të krijojë imunitet. Kjo do të thotë që fëmija juaj do të jetë më i aftë të luftojë gripin.

Vaksina përthithet shumë shpejt në hundë, ndaj edhe nëse fëmija teshtin menjëherë pas spërkatjes, nuk ka pse të shqetësoheni që nuk ka funksionuar.

A ka ndonjë efekt anësor nga vaksina?

Fëmijët mund të kenë rrjedhje ose bllokim të hundës, dhimbje koke, lodhje të përgjithshme dhe pak humbje oreksi. Megjithatë këto janë shumë më pak të rënda sesa shfaqja e gripit dhe ndërlikimet që lidhen me të. Efektet anësore të rënda janë të rralla.

A mund të më shkaktojë gripin vaksina?


Jo, vaksina nuk mund të shkaktojë gripin sepse viruset në të janë dobësuar në mënyrë që të mos ndodhë kjo.

Po nëse fëmija im ka një problem shëndetësor?

Fëmijët që kanë probleme shëndetësore të caktuara, edhe nëse mbahen mirë nën kontroll, janë më të rrezikuar nga komplikacionet e rënda nëse sëmuren me grip. Është veçanërisht e rëndësishme që këta fëmijë të vaksinohen.

Këto probleme shëndetësore përfshijnë:

- sëmundjet e rënda të mushkërive, si për shembull astma, duke pasur nevojë për steroide me thithje ose orale
- sëmundjet e rënda të zemrës
- sëmundje të veshkave ose mëlçisë
- diabeti
- një aftësi e kufizuar në të mësuar
- imunosupresion për shkak të një sëmundjeje ose trajtimi, për shembull trajtim me kimioterapi ose radioterapi për kancerin ose përdorimi i steroideve për kohë të gjatë
- problemet me shpretkën, ngaqë shpretkë është hequr (aspleni) ose nuk funksionon siç duhet, për shembull, për shkak të qelizave drapër ose sëmundjes celiake
- mjeku juaj i përgjithshëm mund të rekomandojë gjithashtu që fëmija juaj të vaksinohet nëse ka një sëmundje që prek sistemin nervor qendror, si për shembull palsy cerebrale



Këta fëmijë duhet të bëjnë vaksinën kundër gripit çdo vit duke filluar nga moshë 6 muaj e më tej. Shumica do të bëjnë vaksinën me spërkatje në hundë, por kjo nuk rekomandohet për fëmijët nën 2 vjeç.

Fëmijëve nën 2 vjeç, dhe fëmijëve për të cilët nuk rekomandohet spërkatja në hundë për arsye mjekësore, do t'u ofrohet një vaksinë kundër gripit me injektim.

Nëse fëmija juaj ka ndonjë nga problemet shëndetësore që tregohen në faqen 8, por nuk bën pjesë në asnjë nga grupmoshat që do të bëjnë vaksinën në shkollë, është e rëndësishme të kontaktoni mjekun e përgjithshëm për të lënë një takim.

Nëse nuk jeni të sigurt nëse fëmija juaj ka nevojë për vaksinën kundër gripit apo nëse keni nevojë për më shumë këshilla, flisni me infermieren e përgjithshme, mjekun e përgjithshëm ose vizitorin e shëndetit.

Si do të bëhet vakcina?

Për fëmijët 2 dhe 3 vjeç, duhet të merrni një ftesë që fëmija juaj ta bëjë te klinika e mjekut të përgjithshëm në vjeshtë. Ose mund ta kontaktoni drejtpërdrejt për të lënë një takim.

Për fëmijët e moshës shkollë, periudha e vaksinimit do të jetë në shkollë gjatë sezonit të vjeshtës. Skuadra e vaksinimit për fëmijët në shkollë do t'ju kontaktojë nëpërmjet shkollës.

Nëse fëmija juaj bën pjesë në një grupmoshë së cilës do t'i ofrohet vakcina në shkollë dhe ka një problem shëndetësor që e bën të jetë i rrezikuar nga gripi (shiko faqen 8), mund të pyesni te klinika e mjekut të përgjithshëm për të siguruar vaksinën nëse nuk doni të prisni derisa të vijë periudha e vaksinimit ose nëse kjo është ajo çka preferoni.

A ka fëmijë të cilët nuk duhet ta bëjnë vaksinën me spërkatje në hundë?

Ngaqë fëmijët me probleme shëndetësore ekzistuese mund të jenë më të prekshëm nga komplikacionet e gripit, është shumë e rëndësishme që të vaksinohen. Fëmijët mund të mos jenë në gjendje të bëjnë vaksinën e hundës nëse:

- aktualisht gulçojnë ose kanë gulçuar në 72 orët e fundit, atyre duhet t'u ofrohet një vaksinë kundër gripit me injektim në mënyrë që mbrojtja të fillojë sa më parë
- kanë nevojë për kujdes intensiv për shkak të
 - astmës ose
 - anafilaksisë alergjike ndaj vezës(Rekomandohet që fëmijët në këto 2 grupe të kërkojnë këshillat e specialistit, dhe mund të kenë nevojë që ta bëjnë vaksinën nazale në spital)
- kanë një problem shëndetësor, ose janë duke bërë trajtim, i cili dobëson rëndë sistemin e tyre imunitar ose jetojnë me dikë në shtëpi që ka nevojë për izolim ngaqë ka sistem imunitar tepër të dobët
- janë alergjikë ndaj ndonjë komponenti tjetër të vaksinës*

Nëse fëmija juaj nuk mund ta bëjë vaksinën nazale kundër gripit, duhet të bëjë vaksinën me injektim.

Nëse nuk jeni të sigurt nëse fëmija juaj duhet të bëjë vaksinën me injektim apo vaksinën nazale, flisni me skuadrën për vaksinimin e fëmijëve në shkollë ose infermierën apo mjekun e përgjithshëm.

Fëmijët që janë vaksinuar me spërkatje në hundë duhet të shmangin kontaktin e ngushtë me njerëz që kanë sistem imunitar shumë të dobësuar (për shembull ata që sapo kanë bërë një transplant të palcës së kockës) për rreth 2 javë pas vaksinimit.

A mund t'i jepet fëmijës tim vakcina kundër gripit në të njëjtën kohë me vaksinat e tjera?

Po. Vakcina kundër gripit mund të jepet në të njëjtën kohë me të gjitha vaksinat e tjera të zakonshme të fëmijërisë. Vaksinimi mund të shtyhet nëse fëmija ka temperaturë. Gjithashtu, nëse fëmija juaj ka hundë tepër të bllokuar ose ka rrjedhje, kjo mund të mos lejojë që vakcina të futet në trup. Në këtë rast, vaksinimi kundër gripit mund të shtyhet derisa simptomat nazale të jenë larguar. Ndonjëherë, në vend të kësaj mund të ofrohet një vaksinë me injektim.



*Vizitoni faqen e internetit në www.medicines.org.uk/emc/product/15790/smpc për të marrë një listë të përbërësve të vaksinës

A përmban vaksina e hundës xhelatinë që nxirret nga derrat (xhelatinë e derrit)?

Po. Vaksina nazale përmban një formë shumë të vogël të xhelatinës nga derri (xhelatinë porcine), e cila përdoret në një shumëllojshmëri mjekimesh të rëndësishme. Xhelatina ndihmon për ta mbajtur vaksinën të qëndrueshme, në mënyrë që të funksionojë mirë.

Spërkatja nazale është vaksina që preferohet për fëmijët, pasi bëhet shpejt dhe lehtë. Gjithashtu mund të jetë më e mirë për të pakësuar përhapjen e gripit në komunitet. Nëse nuk i pranoni mjekimet ose vaksinat që përmbajnë xhelatinë derri, ofrohet një vaksinë me injektim kundër gripit që nuk përmban xhelatinë.

Ku mund të marr më shumë informacion?

Vizitoni www.nhs.uk/child-flu për më shumë informacion. Flisni me mjekun e përgjithshëm, infermieren e praktikës, infermieren e shkollës ose vizitorin e shëndetit nëse keni pyetje të mëtejshme.



www.nhs.uk/vaccinations

© Crown copyright 2025. UK Health Security gateway number: 2024828. Product code: 2025FCAL Albanian. 1P 7K May 2025 (APS).

To order more copies of this guidance please visit: www.healthpublications.gov.uk or call 0300 123 1002.

That this leaflet is available in, Albanian, Arabic, Bengali, Bulgarian, Chinese (simplified), Chinese (traditional, Cantonese), Estonian, Farsi, French, Greek, Gujarati, Hindi, Latvian, Lithuanian, Nepali, Panjabi, Pashto, Polish, Portuguese, Romanian, Romany, Russian, Somali, Spanish, Tagalog, Turkish, Twi, Ukrainian, Urdu and Yiddish.

Accessible versions are also available as an English large print, braille, British Sign Language video and audio version.